

Energjo Qendrat e reja të shrytëzuesve për shërbim më të mirë!

EVN Macedonia në muajin e kaluar zyrtarisht e bëri ribrendimin dhe tani është pjesë e familjes së madhe të EVN-së nën një logo.

Brendi EVN e pasqyron orientimin edhe më të madhe të servisit ndaj shrytëzuesve të shërbimeve tona. Ai i mishëron vlerat siç janë siguri, besimi, shërbimi, puna racionale energjetike dhe afërsia me konsumatorët.

Në procesin e modernizimit të vazhdueshëm dhe të integritit në Koncernin EVN, degët e mëparshme i riorganizuar në a.q.t. **Energjo Qendrat e shrytëzuesve** ose KEC me qëllim që t'u afrohem më afër konsumatorëve tanë dhe t'u mundësojmë kontakt të drejtpërdrejtë, shërbim më të shpejtë dhe më cilësor.

Momentalisht, në shërbimin e tyre, konsumatorët tanë i kanë në dispozicion këto 19 KEC qendrat:

1. KEC-ja Shkup, Aerodrom	11. KEC-ja Kavadar (e përfshin Negotinin)
2. KEC-ja Shkup, Vasill Gllavinov	12. KEC-ja Gjevgjeli (e përfshin Vallandovën)
3. KEC-ja Shkup, Gjorçe Petrov	13. KEC-ja Strumicë (e përfshin Radovishin)
4. KEC-ja Tetovë	14. KEC-ja Veles
5. KEC-ja Gostivar	15. KEC-ja Shtip (e përfshin Shën Nikollën)
6. KEC-ja Kërçovë (e përfshin edhe Mak. Brod)	16. KEC-ja Kumanovë
7. KEC-ja Strugë (e përfshin Dibrën)	17. KEC-ja Kratovë (e përfshin Kriva Pallankën)
8. KEC-ja Ohër (e përfshin Resnjën)	18. KEC-ja Dellçevë (e përfshin Berovën)
9. KEC-ja Manastir	19. KEC-ja Koçan (i përfshin Probishtipin dhe Vinicën)
10. KEC-ja Prilep	

Shërbimet të cilat konsumatorët mund t'i fitojnë në KEC janë:

- Arkëtimi, korigjimi dhe vërtetimet e llogarive për energjinë elektrike
- Këshillimi dhe përkrahja jonë për kyçe të reja në rrjetin distributiv
- Kyçja e sërishme në rrjetin distributiv
- Reagimi i shpejtë në terren në rast defekti
- Kontrolli, ndryshimi dhe vendosja e numeruesve të rinj dhe masat e sigurimit
- Ndryshimi i emrit dhe i adresës të llogarisë
- Mirëmbajtja e rregullt e rrjetit distributiv

Çdo KEC në përbërjen e vet e ka të a.q.t. **Front office** ose **zyrën pranuese** për kontakt të drejtpërdrejtë me konsumatorët dhe **pikat e arkëtimit** në të cilat konsumatorët mund t'i kryejnë aktivitetet e rregullta të lidhura me arkëtimin.



Bashkëpunim me konsumatorët korrektë

Vjedhjet dhe shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike paraqesin vepra kriminale. EVN Macedonia do të luftojë në mënyrë aktive që t'i mposhtë këto dukuri kriminale të cilat seriozisht e kërcënojnë sigurinë dhe stabilitetin e rrjetit distributiv.

Shërbimet tona teknike, pas konstatimit për ekzistimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike ose të vjedhjes **menjëherë do ta shkyçin** konsumatorin nga rrjeti distributiv dhe një-kohësisht do ta **lajmërojnë policinë** si organ kompetent.

Në pajtim me dispozitat ekzistuese ligjore bëhet **llogari për energjinë e harxhuar elektrike në mënyrë të paautorizuar** për periudhë prej 1 deri më 3 vjet. Si plotësim i kësaj shume përlogaritët edhe shuma ndëshkimore. Përlogaritjet për shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë elektrike sillen midis 300.000 dhe 1.800.000 denarësh. Kyçja e sërishme e konsumatorit bëhet **vetëm pas shlyerjes së tërësishme** të borxhit mbi bazën e përlogaritjes së njëjtë.

- Në rast se dyshoni se në afërsinë tuaj të drejtpërdrejtë realizohet shfrytëzimi i paautorizuar ose vjedhja e energjisë elektrike, të njëjtën mund ta denonconi në Qendrën tonë për marrëdhënie me konsumatorët.
- Gjithashtu, në rast se shënoni se diçka nuk është në rregull edhe me kyçjen tuaj të rrjetit distributiv, dhe e njëjta nuk është legale, mund ta denonconi në KEC-në më të afërt, si edhe në Qendrën për marrëdhënie me konsumatorët të EVN Macedonia. Në rast se këtë gjë e bëni vetë, nuk pasojnë kurrëfarë masash ndëshkimore meqë do të bëheni konsumator legal i energjisë elektrike.
- Përpiqemi të vendosim standarde për punë që respektohen edhe brenda kompanisë edhe nga konsumatorët tanë jashtë kompanisë. Prandaj Ju bëjmë apel juve të na njoftoni për rastet kur dikush nga të punësuarit tanë vepron në mënyrë joetike dhe në kundërshtim me rregullat e kompanisë dhe me këtë drejtpërdrejt i kërcënon të drejtat tuaja si konsumator.

Të gjitha denoncimet drejtojani Qendrës sonë për marrëdhënie me konsumatorët, e ar-ritshme për Ju 24 orë në ditë, 365 ditë në vit!

Telefon: 0890 12345

E-mail: info@evn.com.mk



Gjithmonë këtu për Ju
EVN Macedonia